



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA DRENAS
DREJTORATI PËR ARSIM

Dt. 27.09.2022, Nr. 09-MM/01-49451



Në bazë të nenit 64 pika 1 e Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtaret Publikë të Republikës së Kosovës, në vështrim të nenit 8 të Ligjit nr.03/L-212 të Punës, Udhëzimit administrativ nr. 07/2017 për rregullimin e procedurave për themelimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik, Udhëzimit Administrativ të MASHTI, nr. 05/2021 për normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, Udhëzimit Administrativ të MASHT-it, nr. 05/2015 e normativit për mësimdhënësit e arsimit profesional, Drejtorati për Arsim në Drenas, shpallë:

K O N K U R S

1. IAAP "Fehmi Lladrovci" në Drenas

- Një mësimdhënës/e për Infermieri, për vitin shkollor 2022/2023, me mundësi vazhdimi.

2. IAAP "Fehmi Lladrovci" në Drenas

- Një mësimdhënës/e për konfeksion-dizajn, deri sa të kthehet punëtorja prej pushimit të lehonisë.

3. SHML "GJ.K. Skënderbeu" – Drenas

- Një mësimdhënës/e për Matematikë, me kohë të pacaktuar.
- Një mësimdhënës/e për Gjuhë shqipe, me kohë të pacaktuar.
- Një mësimdhënës/e për Psikologji, deri sa të kthehet punëtorja prej pushimit pa pagesë.

4. SHFMU "Xhevë Lladrovci" në Gllansellë

- Një mësimdhënës/e për Edukatë Fizike me 18 orë, prej tyre 12 orë në SHFMU "Xhevë Lladrovci" në Gllansellë dhe 6 orë në SHFMU "Luigj Gurakuqi" në Sankoc, deri me 31.08.2023, me mundësi vazhdimi.

5. SHFMU "Hasan Prishtina" në Llapushnik

- Një mësimdhënës/e për arsim fillor, me kohë të pacaktuar.

6. SHFMU "Mehmet Gradica" në Gradicë

- Një mësimdhënës/e për arsim fillor, me kohë të pacaktuar.

7. SHFMU "Mehdi dhe Sylejman Bytyqi" në Arllat

- Një mësimdhënës/e për arsim fillor, deri sa të kthehet punëtorja prej pushimit të lehonisë.

8. SHFMU "Abedin Bujupi" në Arllat

- Një mësimdhënës/e për arsim fillor, deri sa të kthehet punëtorja prej pushimit të lehonisë.

KUSHTET E PUNËSIMIT:

Për të gjitha vendet e punës kërkohet përgatitje adekuate profesionale (me fakultete përkatëse), sipas U.A.05 / 2021 – MASHTI, 05/2015- MASHT.

DOKUMENTET E NEVOJSHME PËR APLIKIM:

1. Aplikacioni i punësimit.
2. Kopje e dokumentit të identifikimit (letërnjoftim, patentë shofer ose pasaportë)
3. Diploma ose Çertifikata e diplomimit- jo më e vjetër së gjashtë muaj, e vërtetuar ne Komunë ose te Noteri publik.
4. Çertifikatë origjinale që nuk është nën hetime, ose e noterizuar, jo më e vjetër së gjashtë muaj.
5. Vërtetim i përvojës së punës vetëm në arsim (nëse keni).
6. Çertifikatë mjekësore për gjendjen shëndetësore lidhur më çështjen e punësimit. për kandidatët që pranohen në punë.
7. Kopje të Çertifikatave të trajnimeve përkatëse (nëse keni)

REKRUTIMI:

Intervistat me shkrim më gojë dhe përzgjedhjen e kandidatëve do ta bëjë Komisioni i përzgjedhur nga DKA.

VËREJTJE:

Aplikacioni për konkurim merret në zyrat e DKA-së, të plotësohet rrjedhshëm në gjuhën shqipe dhe me shkronja të mëdha të shtypit, dokumentacioni i kompletuar dorëzohet në Arkivin Komunal, ndërsa dokumentet e pakompletuara, ato që arrijnë pas afatit të konkurrimit dhe dokumentet shtesë jashtë dorëzimit në arkiv nuk pranohen.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga data e publikimit në mjetet e informimit.

Drenas,

Më:27.09.2022

